

INDEKSI I INTEGRITETIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE

JANAR 2024



Institute
for Democracy
and Mediation

AUTORËT:

Boris Divjak
Mimosa Agolli

REDAKTORE:

Rovena Sulstarova

REDAKTOR LETRAR:

Durim Tabaku

PËRKTHEU NË SHQIP:

Durim Tabaku

DIZAJN DHE LAYOUT:

Eduart Cani

© 2024 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1

1017 Tirana, Albania

E-mail: info@idmalbania.org

www.idmalbania.org



Institute
for Democracy
and Mediation



Suedi
Sverige

Ky dokument është hartuar në kuadër të Projektit "Forcimi i integritetit për përmirësimin e shërbimeve publike" zbatuar nga IDM Albania me mbështetjen financiare të Ambasadës Suedeze në Tiranë. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Ambasadës Suedeze në Tiranë.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	5
INDEKSI I INTEGRITETIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE	6
METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË INTEGRITETIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE	7
UDHËZIME PRAKTIKE PËR ZBATIMIN E INSTRUMENTIT	11
REFERENCA	28

HYRJE

Përballja me sfida morale karakterizon çdo shoqëri, pavarësisht shkallës së zhvillimit. Integriteti nënkupton respektimin e këtyre sfidave morale dhe etike. Ndaj, integriteti mbetet një sistem vlerash. Krijimi i një kulture integriteti në sistemin publik është i vështirë, sepse shpesh përfitimet nga sjellje dhe vendime jo-etike, të cilat çojnë në akte korruptive, janë mjaft të larta. Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e përgjegjësive në sektorin publik, aktet korruptive variojnë nga ryshfeti në shkallë të vogël deri te kapja e shtetit. Aktet korruptive mund të ndodhin në aktivitete të ndryshme të institucioneve publike, të tilla si emërimi i personelit, prokurimi i shërbimeve, dhënia dhe kontrolli i lejeve, licencave apo koncesioneve, etj. (Graycar 2015, Graycar dhe Sidebottom 2012)¹

Kuadri ligjor, nënligjor dhe administrativ si dhe natyra e akteve korruptive do të ndikojnë ndjeshëm në masat që do të ndërmerren për të promovuar integritetin në sektorin publik. Forcimi i integritetit të institucioneve publike është një objektivi afatgjatë, i cili kërkon reforma strukturore, ndryshime në kulturën institucionale si dhe miratimin dhe zbatimin e kornizave të forta ligjore.

Korrupsioni në Shqipëri raportohet si një nga pengesat më të mëdha të vendit në sfidën e ndërtimit të shtetit të së drejtës, për zhvillimin dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Sipas Raportit Progresit të Komisionit Evropian (2023), ecuria e masave të marra për të forcuar integritetin e institucioneve publike është pozitive. Institucione të qeverisjes qendrore dhe 23 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë miratuar dhe po zbatojnë planet e integritetit. Pavarësisht progresit të bërë, Shqipëria duhet të intensifikojë përpjekjet për hartimin, miratimin dhe vënien në zbatim të planeve të integritetit në të gjitha institucionet publike. Qeveria duhet të sigurojë që masat e marra për forcimin e integritetit të zbatohen plotësisht dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme. (Raporti i Progresit të BE-së 2023)

Lufta kundër korrupsionit nuk është thjesht një çështje e zbatimit të ligjit. Viktimë e korrupsionit është edhe vetë sistemi dhe vlerat morale, ndaj për këtë arsye forcimi i integritetit të sistemit publik kombëtar vijon të mbetet një masë efektive në parandalimin e korrupsionit. Angazhimi për reformimin e integritetit në institucionet publike kërkon përpjekje koordinuara, transparencë dhe gatishmëri për të bashkëpunuar në sektorë të ndryshëm. Kjo përpjekje është një rrugëtim kolektiv, që kërkon jo vetëm angazhimin e qeverisë, por edhe pjesëmarrje aktive dhe mbështetje nga shoqëria civile, bizneset dhe individët.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë ka hartuar metodologjinë e vlerësimit të integritetit institucional si përpjekje për të monitoruar zbatimin e planeve të integritetit të institucioneve publike dhe ndikimin që kanë pasur këto masa në forcimin e integritetit institucional. Hartimi i instrumentit është mbështetur në përvojën që IDM ka përfituar tashmë në hartimin dhe zbatimin e instrumenteve të integritetit (Plan Integriteti dhe Kod Etike) në disa institucione publike në vend. Hartuesi kryesor i këtij instrumenti është Z. Boris Divjak, bashkëpunëtor i Transparency International, me përvojë të gjatë në vlerësimin e integritetit të institucioneve në vendet e Evropës Juglindore. Ky instrument është konsultuar edhe me institucione publike që kanë në fushëveprimin e tyre në luftën kundër korrupsionit si: Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit; Inspektorati i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si dhe Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu, instrumenti u pilotua në dy institucione publike, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në sajë të gjetjeve të procesit të testimit u finalizua instrumenti dhe u hartuan rekomandime metodologjike për zbatimin e këtij vlerësimi.

1 Adam Graycar and Aiden Sibbentom (2012). Corruption and control: A corruption reduction approach. Journal of financial Crime 19 (4). https://www.researchgate.net/publication/263695877_Corruption_and_Control_A_Corruption_Reduction_Approach

INDEKSI I INTEGRITETIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Ky indeks i integritetit është përgatitur për t'u zbatuar nga aktorë të shoqërisë civile, ekspertë, të informuar dhe të përfshirë në luftën kundër korrupsionit dhe për qeverisjen e mirë. Përfaqësuesit e shoqërisë civile janë aktorë të pavarur, që kanë shërbyer si watchdog i të mirës dhe interesit publik, me kapacitetet e nevojshme për të kryer këtë vlerësim në mënyrë të qëndrueshme. Indeksi është hartuar në një mënyrë që të jetë i vlefshëm dhe përfaqësues për të gjitha institucionet publike të cilat kanë miratuar një plan integriteti dhe e kanë zbatuar ose janë në proces zbatimi të tij.

Indeksi i integritetit është një mekanizëm që vlerëson: kuadrin institucional për promovimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit kapacitetet institucionale për përmbushjen e objektivave të integritetit të vendosura nga institucioni nëpërmjet planeve të integritetit; transparencën dhe llogaridhënien e institucionit ndaj përfituesve të shërbimeve; dhe nëse ai e realizon veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nisur nga ky synim, instrumenti shërben si material burimor për institucionet publike në realizimin e veprimtarisë funksionale të tyre, për të përmbushur objektivat institucionale dhe ato të integritetit si dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike që ato ofrojnë. Rezultatet e vlerësimit kontribuojnë në forcimin e një kulture pro- integritet në administratën publike, rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë për rezultatet nga zbatimi i planeve të integritetit në këto institucione. Gjithashtu, nëpërmjet vlerësimit ofrohen informacione të bollshme në lidhje me metodat për planifikimin, zbatimin, realizimin dhe raportimin e planeve të integritetit, për vlerësuesit e institucioneve publike (shoqëri civile dhe ekspertë).

Indeksi i integritetit i institucioneve publike përbëhet nga dy pjesë. Në pjesën e parë, përshkruhet metodologjia e vlerësimit të integritetit të institucioneve publike. Në pjesën e dytë trajtohen udhëzime që e drejtojnë dhe lehtësojnë procesin e vlerësimit nga ana e vlerësuesit, të tilla si: kriteret e vlerësimit, dokumentacionet orientuese dhe burimet e mbledhjes së të dhënave për vlerësimin e institucioneve publike.

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË INTEGRITETIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Indeksi i integritetit i institucioneve publike ofron një kuadër të përgjithshëm për të analizuar dhe kuptuar se çfarë masash ka ndërmarrë një institucion për të forcuar integritetin institucional duke përfshirë në këtë analizë proceset funksionale, aktivitetin e institucionit si dhe ndërveprimin me aktorë të tjerë përfshirë këtu publikun, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe grupet e interesit. Ndonëse pjesa më e madhe e analizës është shumë cilësore, vlerësimi përmbledhet në mënyrë sasiore duke klasifikuar përgjigjet e një sërë treguesish në tregues të kuantifikuar.

Indeksi i integritetit i institucioneve publike, duke mbajtur në konsideratë aspektet e etikës dhe integritetit në sektorin publik dhe proceset funksionale në institucionet publike, ka përcaktuar 5 fusha të vlerësimit të integritetit të institucioneve publike, përkatësisht:

1. Llogaridhënia;
2. Transparenca;
3. Qasja strategjike ndaj integritetit;
4. Standardet e integritetit dhe
5. Meritokracia e burimeve njerëzore.

Për secilën fushë të vlerësimit, janë hartuar tregues vlerësimi, të cilat mundësojnë interpretimin e informacionit ekzistues apo atë të përfituar nga intervistat me personat informatorë kryesorë. Kriteret e vlerësimit synohet të jenë të vlefshme, transparente dhe të zbatueshme.

Fushat e vlerësimit të integritetit vlerësohen sipas dy kriterëve:

1. kontrolli ligjor dhe institucional;
2. kontrolli i zbatimit në praktikë.

Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe institucional është kriteri i parë, si mënyrë për të verifikuar ekzistencën e parakushteve ligjore dhe institucionale si dhe për të patur institucione me integritet dhe të pakorruptueshme. Ky kriter do të bashkërendohet me institucionit që do të vlerësohet dhe vlerësuesit. Vlerësimi praktik i zbatueshmërisë e kriterëve të integritetit në nivel institucional është kriteri i dytë i vlerësimit. Në kontrollin praktik të zbatimit, vlerësuesi duhet të ketë parasysh praktikën e mira (nga pyetjet apo deklaratat orientuese) dhe më pas të përcaktojë se sa përputhen ato me standardet e vendosura dhe sa respektohen këto të fundit nga institucioni që është në vlerësim.

Kontrolli ligjor dhe institucional vlerësohet në bazë të disponueshmërisë së të dhënave ose mungesës së tyre në institucion. Për të realizuar kontrollin ligjor do të vlerësohet ekzistenca e akteve të brendshme rregullatorë dhe administrative, dokumente e të dhëna administrative si dhe struktura institucionale funksionale në mbështetje të forcimit të integritetit institucional. Sipas nevojës shqyrtohen dhe mblidhen rregulloret, aktet dhe dokumentet përkatëse.

Kontrolli i zbatimit në praktikë është paksa i ndryshëm, pasi vlerësimi i zbatimit në praktikë kërkon një gjykim subjektiv që duhet të jepet nga vlerësuesi për përpjekjet dhe arritjet institucionale në funksion të forcimit të integritetit. Vlerësimi i zbatimit në praktikë do të bazohet në vëzhgimet dhe provat e mbledhura nga vlerësuesi nëpërmjet intervistave² dhe analizës së dokumentacionit dhe të dhënave administrative të vëna në dispozicion nga institucioni. Kontrolli duhet të organizohet dhe miratohet paraprakisht nga institucioni dhe si ky i fundit ashtu edhe vlerësuesi(t) do të duhet të punojnë së bashku.

Vlerësimi do të realizohet duke përcaktuar treguesit për çdo fushë vlerësimi. Treguesit zbërthehen në dokumente ligjore, administrative ose tregues (statistikorë), të cilët shërbejnë për të evidentuar përpjekjet e institucionit për përmirësimin e integritetit institucional. Treguesit për çdo fushë vlerësimi janë detajuar në tabelat nr. 3 deri në tabelën nr. 7 më poshtë. Vlerësuesit do të angazhohen me përfaqësues të institucionit për ta mbledhur këtë informacion, për ta analizuar dhe vlerësuar me shkallën e vlerësimit të përcaktuar. Çdo tregues vlerësimi është pikëzuar. Vlerësimi përveçse krijon një arkiv të dokumenteve administrative e rregullatore dhe një përmbledhje përshkruese të situatës, bën të mundur edhe një vlerësim të kuantifikuar, transparent dhe të vlefshëm për standardizimin e instrumentit si dhe analiza krahasuese mes institucioneve të vlerësuara.

Indeksi i Integritetit ka pesë fusha vlerësimi. Ndarja e pikëve sipas fushave është e barabartë - 20 pikë secila. Po ashtu, ndarja e vlerësimit mes dy kriterëve bazë, atij të kontrollit ligjor dhe kriterit të zbatimit në praktikë është me pikë të barabarta - 10 pikë secila. Çdo fushë i jep institucionit 20 pikë, ndërkohë që të dy kriteret, kontrolli ligjor dhe kriteri i zbatimit praktik, kur plotësohen, i sigurojnë institucionit pikë të barabarta.

Çdo institucion publik dëshiron të ketë rezultate sa më të larta në këtë vlerësim. Totali i lartë i pikëve të mbledhura në këtë vlerësim tregon se institucionet janë të suksesshme në zbatimin e mekanizmave të integritetit si në aspektin ligjor dhe institucional ashtu edhe në zbatimin praktik të tyre. Niveli i ulët i pikëve të mbledhura nga vlerësimi do të thotë se institucionet e vlerësuara duhet të hartojnë një strategji institucionale për të intensifikuar përpjekjet e tyre për forcimin e integritetit.

Për interpretimin e rezultateve, nga pikët e mbledhura për këtë vlerësim, pikëzimi ndahet në tre nivele: i) Niveli i parë: 0-33 pikë nga totali i pikëve përfaqëson institucionet me nivelin bazë të integritetit institucional; ii) Niveli i dytë: 34-66 pikë në total do të thotë se institucioni ka arritur një nivel të ndërmjetëm zhvillimi, ndërsa, iii) Niveli i tretë: 67-100 pikë në total nënkupton se institucioni është i fortë, i pavarur me integritet të lartë, një lider në rregullimin dhe organizimin e veprimtarive të tij.

Informacion të rëndësishëm për institucionet japin edhe rezultatet sipas kriterëve të vlerësimit, ato për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe institucional dhe zbatimit të tij në praktikë. Për secilin kriter vlerësimi, pikëzimi ndahet në tre nivele, të pasqyruara në tabelat 1 dhe 2 më poshtë. Një rezultat i arritur më i lartë në kriterin e parë dhe më i ulët në të dytën tregon se cili është fokusi me më shumë përparësi për të forcuar institucionin në vlerësim.

2 Intervista me burime të pavarura, ish-stafi, OSHC-të, klientët e institucionit, shkrimet e qytetarëve në media, etj.), por institucioni nuk mund të bëjë renditjen e vetvetes kur vjen fjala te zbatimi në praktikë.

Tabela 1. Kontrolli ligjor dhe institucional

Niveli bazë i zhvillimit të integritetit institucional (0-15 p)	Niveli i ndërmjetëm i zhvillimit të integritetit institucional (16-30 p)	Niveli i përparuar i zhvillimit të integritetit institucional (31- 49 p)
Institucioni publik ka miratuar rregulla (rregullore dhe akte administrative) që rregullojnë aspekte të veçanta të integritetit institucional jo-gjithëpërfshirëse; përshkruajnë pak, në mos asnjë, nga elementët e integritetit institucional. Në disa raste, kemi mundësi të plotë të trajtimit të koncepteve ligjore për çështje të integritetit institucional.	Institucioni publik ka miratuar rregullore dhe akte (përfshirë këtu edhe aktet administrative) që rregullojnë elementë të integritetit institucional. Institucioni publik në veprimtarinë e tij përgjithësisht mbështetet në këto rregullore dhe akte.	Institucioni publik ka miratuar, rregulloret e brendshme, aktet administrative, planet operative (rregullat dhe procedurat) dhe të gjithë formularët, mekanizmat monitorues, etj., në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi që rregullojnë aspekte të veçanta të integritetit institucional. Ato janë në një format të përcaktuar qartë dhe të gjitha njësitë e institucionit e kanë të qartë se si duhet të përdoren këto dokumente.

Tabela 2. Kontrolli i zbatimit në praktikë

Niveli bazë i zhvillimit të integritetit institucional (0-15 p)	Niveli i ndërmjetëm i zhvillimit të integritetit institucional (16-31 p)	Niveli i përparuar i zhvillimit të integritetit institucional (32-51 p)
Institucioni publik ka miratuar disa rregullore të cilat trajtojnë pak, në mos asnjë, nga elementët e integritetit institucional, por nuk ka një qasje gjithëpërfshirëse për menaxhimin e integritetit, në aspektin e planifikimit, zbatimit, raportimit dhe monitorimit.	Institucioni publik në shumicën e aspekteve të integritetit, zbaton standardet e integritetit; pjesa më e madhe e proceseve administrative bazohen në parimet e integritetit; dhe rregullat e procedurat e kuadrit aktual të brendshëm të institucionit janë hartuar e miratuar dhe janë vënë në punë. Funkcionet e planifikimit, zbatimit, raportimit, monitorimit dhe vlerësimit zbatohen në pjesën më të madhe të veprimtarisë së institucionit.	Institucioni publik ka secilin nga aspektet e renditura të integritetit të organizuar në mënyrë të rregullt sipas standardeve të integritetit; proceset administrative brenda institucionit kryhen sipas parimeve të integritetit, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara të kuadrit ligjor në fuqi, si edhe sipas dokumenteve të politikave të institucionit. Funkcionet e planifikimit, zbatimit, raportimit, monitorimit dhe vlerësimit zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe institucioni është lider integriteti me sjelljen e tij institucionale.

Institucionet publike në vlerësim mund të krahasohen në mënyrë sasiore duke parë rezultatin total për secilin prej tyre (pikët e mbledhura në total nga të dyja kriteret e vlerësimit), ndonëse një krahasim i tillë nuk evidenton natyrën cilësore të renditjes (mundësisht në kllapa mund të tregohen edhe dy pikët për zbatimin institucional dhe në praktikë, për të ofruar më shumë hollësi). Por, për qëllimin praktik të nxitjes së konkurrencës mes institucioneve, renditjet do të tërheqin vëmendjen e publikut.

UDHËZIME PRAKTIKE PËR ZBATIMIN E INSTRUMENTIT

Instrumenti është hartuar në një mënyrë që të jetë i vlefshëm dhe përfaqësues për të gjitha institucionet publike qendrore. Mund të ndodhë që një kërkesë në instrument të mos jetë e vlefshme për një nga institucionet e vlerësuara. Në këto raste pikët e vlerësimit i jepen të plota institucionit, në mënyrë që të mos krijojë mungesa në vlerësim. Vlerësuesi pritët të bashkëpunojë ngushtë me institucionin që vlerësohet, pasi vlerësimi kryhet duke marrë parasysh institucionin në tërësinë e vet dhe duke vlerësuar informacionin dhe të dhënat që institucioni i vë në dispozicion.

Në secilën fushë, të paraqitur në tabelat e mëposhtme (3-7), jepen sugjerime metodologjike për vlerësuesin në lidhje me kriteret e vlerësimit dhe evidencat përkatëse. Indeksi i Integritetit siguron hapësira për arkivimin e dokumentacionit dhe standardizimin e të dhënave.

Tabela 3: Indeksi i Integritetit - Llogaridhënia

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime Metodologjike
Transparenca proaktive	Publikimi në faqen zyrtare të internetit i kontakteve për Koordinatorin për të Drejtën e Informimit	2	Eksperti vlerëson me pikë nëse janë të publikuara kontaktet e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.
	Publikimi i rregullores së brendshme të institucionit të miratuar.	2	Eksperti vlerëson me pikë nëse rregullorja e brendshme e institucionit është hartuar, miratuar dhe publikuar.
Kudri konsultativ	Publikimi i planit vjetor i konsultimit publik.	2	Eksperti vlerëson me pikë nëse plani i konsultimeve publike i vitit kalendarik para vlerësimit ekziston.
	Institucioni ka të arkivuara procesverbalet e takimeve konsultative, inputin e marrë nga platformat online të konsultimit publik.	2	Eksperti konfirmon ekzistencën e procesverbaleve nga takimet konsultative, sipas planit vjetor të konsultimeve publike. Ai zgjedh të vlerësojë nga ana përmbajtjesore dy praktika të konsultimit publik (një nga të cilat vjen nga platforma online).
	Publikimi i Raportit Vjetor për Konsultimin Publik.	2	Eksperti vlerëson nëse Raporti i Konsultimit Publik është publikuar ose nga vetë institucioni ose si pjesë e platformës kombëtare të konsultimit online.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime Metodologjike
Kontrolli i zbatimit në praktikë			
Transparenca e institucionit	Programi i Transparencës së institucionit është i plotësuar dhe i përditësuar.	2	Eksperti analizon Programin e Transparencës (PT) të institucionit dhe vendos pikët maksimale nëse gjithë elementët e PT përmbajnë adresa aktive në internet dhe informacione. Nëse PT rezulton se ka të paktën 3 rubrika pa informacion, eksperti vendos vetëm gjysmën e pikëve të vlerësimit. Nëse PT e institucionit ka mbi 5 rubrika pa informacion vlerësimi do të jetë 0 pikë. Rekomandohet që eksperti të kryejë një intervistë me Koordinatorin për të Drejtën për Informimin për institucionin.
	Raporti i kërkesave për informim që kanë marrë përgjigje kundrejt totalit të kërkesave për informim që i janë drejtuar institucionit.	1	Eksperti vlerëson/analizon regjistrin e kërkesave për informim, të publikuar në Programin e Transparencës dhe vlerëson raportin mes kërkesave të dërguara dhe kërkesave të plotësuara. Nëse ky raport është më i vogël se 90%, institucioni vlerësohet me zero pikë. Nëse ky raport ka >90%, ai vlerësohet me pikë të plota.
	Numri mesatar i ditëve për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion.	1	Eksperti vlerëson numrin mesatar të ditëve për t'i kthyer përgjigje kërkesave për informim. Ky informacion gjendet në PT, regjistri i kërkesave (mesatarja = shumën e ditëve për kthim përgjigje/numrin total të kërkesave). Nëse ky tregues është deri 10 ditë, institucioni vlerësohet me pikët maksimale, nëse është mes 11-25 ditë vlerësohet me gjysmën e pikëve, nëse është >25 ditë kalendarike vlerësohet me 20% të pikëve.
	Institucioni vë në dispozicion të publikut një faqe dinamike interneti ku ofrohet informacion i përditësuar dhe publiku informohet në kohë.	2	Eksperti vlerëson faqen zyrtare të internetit të institucionit. Në faqen zyrtare të internetit në rubrikën e lajmeve, aktiviteteve dhe raporteve, eksperti i referohet vetëm raportit e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Nëse publikimi i bërë së fundmi është i para një viti, institucioni vlerësohet me 0 pikë, në të kundërt merr vlerësimin e plotë.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Verifikimi	Vlerësimi	Shënime Metodologjike
Institucionalizimi i konsultimeve publike: afatet dhe procedura e kryerjes së konsultimit publik në praktikë.			Eksperti duhet të vlerësojë procesin e konsultimit publik të institucionit dhe ndikimin e tij në politikëbërje. Eksperti i referohet raportit të konsultimit publik të një viti kalendarik përpara vlerësimit. Ky raport hartohet nga institucioni. Konsultimet e institucionit raportohen edhe nga platforma online e konsultimeve publike. (https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/ListaeRaporteve) Ka një tërësi treguesish që mund të nxirren dhe vlerësohen. Për të kuptuar dhe vlerësuar këtë komponent të transparencës rekomandohet që eksperti të kryejë një intervistë të thelluar me Koordinatorin për Konsultimin Publik në institucion.
	Raporti mes planit vjetor të konsultimit publik/realizimit të konsultimit publik.	2	Indeksi i realizimit të planit të konsultimeve >80%, nëse jo vlerësohet me 0 pikë.
	Numri i aktiviteteve të konsultimit publik të pasqyruara në procesverbale/numrit total të aktiviteteve konsultuese të organizuara.	1	Kur ka procesverbale për më shumë se 50% e aktiviteteve të konsultimit publik, institucioni vlerësohet me pikë të plota; nëse ka <50%, vlerësohet me 0 pikë.
	Numri i komenteve dhe sugjerimeve të marra nga aktivitetet e konsultimit publik të pranuar/ kundrejt numrit total të rekomandimeve/ sugjerimeve të dhëna gjatë konsultimit publik.	1	Nëse ky raport është >25%, institucioni vlerësohet me pikët maksimale; nëse raporti është <25%, ai vlerësohet me 0 pikë.
Totali i Vlerësimit		20	

Tabela 4: Indeksi i Integritetit - Transparenca Proaktive

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i Vlerësimit/ Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Shënime metodologjike
Mekanizmat e llogaridhënies	Programi i Transparencës përmban planin vjetor dhe raportin vjetor të institucionit publik të miratuar.	1	Për të qenë të qëndrueshëm me objektivin e këtij kriteri eksperti duhet të përgatisë një listë me dokumente planifikimi dhe raportimi që institucioni duhet të bëjë transparente. Institucionet në varësi të funksionit të tyre mund të kenë akte të brendshme, dokumente strategjike dhe raportime të ndryshme, të tilla si Rregullorja e Brendshme e Institucionit; Raporti Vjetor i Aktivitetit; Plani Buxhetor Afatmesëm; Raporti i Monitorimit të PBA-së; Plani vjetor i Prokurimeve. Nëse këto dokumente (të vitit përpara vlerësimit) janë online dhe të aksesueshme, eksperti vlerëson institucionin me pikët maksimale. Nëse mungon qoftë edhe një dokument nga lista e dakordësuar me institucionin, eksperti e vlerëson institucionin me 0 pikë.
	Evidentohen dallime në zbatimin e aktiviteteve (krahasuar me planin). Në raportin vjetor të monitorimit të buxhetit, raporti fakt/plan është >85%.	1	Diskutohet me përfaqësues të institucionit, se cili tregues monitorimi përfaqëson më mirë raportin e realizimit të planit. Në mungesë të sugjerimeve nga ana e institucionit, eksperti vlerëson raportin fakt/plan të buxhetit të një viti para vlerësimit. Nëse ky indeks është >85%, institucioni vlerësohet me pikë të plota. Nëse është më i ulët, ai vlerësohet me 0 pikë.
Auditi i jashtëm	Institucioni ka kaluar një auditim të jashtëm (KLSH/Autoritete Mbikëqyrëse/ BE/ Auditues të Pavarur) në tre vitet e fundit.	1	Nëse ekziston një raport i tillë në tre vitet e fundit nga koha e vlerësimit të integritetit, institucioni vlerësohet me 1 pikë; në të kundërt merr vlerësim me 0 pikë.
	Raporti i Auditimit të fundit të jashtëm është i publikuar nga institucioni, duke përfshirë edhe listën e rekomandimeve.	1	Vlerësohet me pikë institucioni që bën publike gjetjet e auditimit të jashtëm të fundit, 0 pikë në të kundërt.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i Vlerësimit/ Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Shënime metodologjike
	Institucioni ka përgatitur planin e adresimit të rekomandimeve bazuar në raportin e fundit të auditimit të jashtëm.	1	Institucioni ka përgatitur planin e adresimit të rekomandimeve bazuar në raportin e fundit të auditimit të jashtëm. Ky plan i vihet në dispozicion ekspertit të vlerësimit. Institucioni vlerësohet me pikë nëse ky plan ekziston dhe është bërë publik.
Auditi i brendshëm	Dokumenti i Kartës së Auditimit (statusi i organizatës, qëllimi, misioni, objektivat e punës, llogaridhënia dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm) është hartuar dhe miratuar.	1	Njësia e Auditit konfirmon ekzistencën e dokumentit, eksperti verifikon dhe bën vlerësimin.
	Rregullat e sjelljes dhe parimet që duhet të udhëheqin punën e auditorëve të brendshëm si dhe plani i punës janë hartuar, miratuar dhe vënë në zbatim.	1	Eksperti merr informacion nga Njësia e Auditit dhe konfirmon ekzistencën e: planit vjetor të auditimit për vitin kur bëhet vlerësimi; dhe raporti vjetor i aktivitetit i një viti para vlerësimit, miratuar nga strukturat mbikëqyrëse dhe eprori. Nëse ekzistojnë të dy dokumentet e aprovuar vlerësimi merret i plotë. Nëse mungon njëri nga dokumentet, vlerësimi është me 0 pikë.
Matja e kënaqshmërisë së klientit	Ekziston një sistem i monitorimit të vazhdueshëm të kënaqësisë së klientit, ka evidenca se gjetjet e këtij vlerësimi janë të përfshira në planin operativ/programin e punës.	1	Eksperti vlerëson me 0 pikë nëse nuk ekziston një studim i tillë në 5 vitet e fundit. Në të kundërt eksperti vlerëson institucionin me pikë të plota.
	Të sigurohen evidenca se gjetjet e këtij vlerësimi janë të përfshira në planin operativ/programin e punës.	2	Eksperti identifikon nëse rekomandime nga ky vlerësim janë përfshirë në planin vjetor të aktivitetit të institucionit. Institucioni vlerësohet me pikë të plota nëse evidentohet qoftë dhe një rekomandim i tillë. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
Kontrolli i zbatimit në praktikë		10	

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i Vlerësimit/ Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Shënime metodologjike
Funksionaliteti i mekanizmave të llogaridhënies horizontale dhe vertikale	Institucioni ka të paktën një autoritet mbikëqyrës, në të cilin raporton në mënyrë periodike.	1	Eksperti vlerëson me pikë të plota institucionin nëse mbikëqyret dhe raporton mbi aktivitetin e tij para të paktën një autoriteti (parlamenti, autoritete mbikëqyrëse, Këshilli i Ministrave, institucione ndërkombëtare etj.). Eksperti rakordon me përfaqësuesin e institucionit për autoritetin që raporton.
	Institucioni përgatit të paktën një raport vjetor, i cili shqyrtohet dhe miratohet nga autoriteti mbikëqyrës i tij dhe bëhet publik.	1	Të listohen raportet/dokumentet e përgatitura dhe dorëzuar nga institucioni/aprovuar nga autoriteti mbikëqyrës. Të paktën një dokument i tillë ekziston dhe eksperti vlerëson me pikë të plota institucionin. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	Institucioni përgatit nëpërmjet ekspertëve të jashtëm raport të monitorimit të planit vjetor ose strategjisë sektoriale (të paktën njëherë në tre vjet).	2	Eksperti vlerëson me pikë të plota nëse së paku një raport monitorimi është publikuar në tre vitet e fundit dhe 0 pikë në të kundërt.
	Nga vlerësimi i raportit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm të fundit rezulton se 80% e rekomandimeve janë adresuar nga një plan veprimi të miratuar dhe bërë publik.	2	Eksperti realizon një intervistë me përfaqësues të drejtorisë së auditimit dhe dakordëson me to listën e dokumentacionit që do duhet të vlerësojë. Në parim eksperti mund të gjejë online pranë KLSH-së raportet e auditimit të institucionit (të fundit të kryer); planin e veprimit të institucionit për të adresuar rekomandimet e auditimit të jashtëm. Nga analiza e dokumentacionit ndërtohet indeksi i vlerësimit. Institucioni vlerësohet me pikë nëse 80% e rekomandimeve të auditimit të jashtëm janë adresuar, dhe 0 pikë në të kundërt. Ky vlerësim synon të kapë masën në të cilën standardet e llogaridhënies janë zbatuar në praktikë.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i Vlerësimit/ Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Shënime metodologjike
	Nga vlerësimi i raportit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm (i një viti më përpara) rezulton se 80% e rekomandimeve janë adresuar nga një plan veprimi të institucionit.	2	Ekspertit i vihet në dispozicion një nga raportet e auditimit të brendshëm, të zgjedhur rastësisht nga programi vjetor i auditimit të institucionit (nga viti paraardhës). Institucioni duhet t'i vejë në dispozicion ekspertit planin e adresimit të rekomandimeve të raportit të auditimit të brendshëm, nga i cili eksperti vlerëson sa % e rekomandimeve janë adresuar. Institucioni vlerësohet me pikë nëse 80% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm janë adresuar, dhe 0 pikë në të kundërt.
	Ka dispozita të shumta për të siguruar që institucioni realizon përgjegjësitë e tij të prokurimit publik në mënyrë të ligjshme dhe etike. Institucioni publikon Planin e Prokurimeve (0.5 pikë).	0.5	Institucioni publikon Planin e Prokurimeve dhe eksperti vlerëson me pikë të plota. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	Raporti mes planit/faktit të prokurimeve është mbi 50%.	0.5	Eksperti vlerëson nëse raporti mes planit/faktit të prokurimeve është mbi 50% duke i dhënë pikë të plota institucionit. Në të kundërt eksperti vlerëson institucionin me 0 pikë.
	Raporti prokurime të drejtpërdrejta (në vlerë)/totalit të prokurimeve është <25% (0.5 pike).	0.5	Eksperti vlerëson nëse raporti prokurime të drejtpërdrejta (në vlerë)/totalit të prokurimeve është <25% dhe vlerëson me pikë të plota institucionin. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	Raporti numri i kontratave me probleme/ totalit të kontratave është < 25% (0.5 pikë).	0.5	Eksperti vlerëson nëse raporti numri i kontratave me probleme/totalit të kontratave është < 25% dhe vlerëson me pikë të plota institucionin. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
		10	
Vlerësimi Total		20	

Tabela 5: Indeksi i Integritetit - Qasja Strategjike

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Shënime metodologjike
Planifikimi i operacioneve të institucionit	Institucioni ka të publikuar Planin e Zhvillimit Strategjik të institucionit dhe Planin e Veprimit.	2	Eksperti duhet të dakordësojë me institucionin që vlerëson tërësinë e dokumenteve strategjike të cilat përfaqësojnë misionin dhe vizionin e institucionit. Në këtë fazë të vlerësimit, bazuar dhe në konsultimet me institucionet e pilotuara janë konsideruar ekzistenca e Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit dhe plani i veprimit përkatës. Nëse ky dokumentacion ekziston institucioni vlerësohet me pikët e plota, nëse nuk ekziston vlerësohet me 0 pikë.
	Institucioni ka të publikuara Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) ose gjurmët e auditimit për proceset e punës së institucionit	2	Eksperti konsulton dokumentin dhe vlerëson institucionin. Ai vlerëson me pikë të plota nëse institucioni ka të publikuar PSV (edhe nëse janë pjesë në dokumente strategjike apo rregulloren e brendshme). Nëse nuk ekziston institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	Institucioni ka të publikuar raport monitorimi të zbatimit të Planit Strategjik të Institucionit	2	Eksperti vlerëson me pikë të plota nëse dokumentet strategjike ekzistojnë. Përgatit një listë të dakordësuar me përfaqësuesit e institucionit. Arkivo dokumentacionin e cituar ose vendos links). Nëse nuk ekziston asnjë nga dokumentet e dakordësuara vlerësohet me 0 pikë.
Planifikimi i menaxhimit të integritetit	Institucioni ka të publikuar Planin e Integritetit, të miratuar dhe përditësuar.	1	Eksperti vlerëson me pikë të plota nëse ekziston plani i integritetit apo rishikim i planit. Nëse nuk ekziston institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	Institucioni ka monitoruar dhe ka hartuar një Raport Monitorimi të Planit të Integritetit	1	Institucioni vlerësohet me pikë të plota nëse në tre vitet e fundit ka monitoruar zbatimin e planit të integritetit. Nëse nuk ekzistojnë raporte monitorimi vlerësohet me 0 pikë.
Zbatimi i sistemit të menaxhimit të integritetit	Institucioni ka ngritur një strukturë të brendshme (grup pune/koordinator) për zbatimin e planit të integritetit.	2	Institucioni vlerësohet me pikë të plota kur struktura është ngritur/caktuar personi përgjegjës në institucion. Nëse nuk ekziston institucioni vlerësohet me 0 pikë.
Kontrolli ligjor dhe institucional		10	
Kontrolli i zbatimit në praktikë			

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Shënime metodologjike
Menaxhimi organizativ dhe menaxhimi i integritetit kryhet nëpërmjet një qasjeje strategjike	Plani i integritetit për institucionin bazohet në analizën e risqeve ndaj integritetit dhe përmban masa për menaxhimin e tyre.	2	Eksperti vlerëson planin e integritetit dhe raportin - numrin e masave të hartuara, lidhjen e masave me risqet e identifikuar, planin e zbatimit dhe treguesit e monitorimit. Institucioni vlerësohet me pikë të plota nëse plani i integritetit është publikuar dhe manifeston lidhje të qartë me risqet ndaj integritetit të institucionit. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	Numri i masave me rrezik të lartë kundrejt totalit të masave është >25%.	2	Plani i integritetit ka fokus risqet ndaj integritetit institucional. Ky tregues llogaritet nga Plani i Integritetit. Nëse evidentohet që numri i masave me rrezik të lartë kundrejt totalit të masave është >25%, merr pikë të plota. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	Institucioni monitoron zbatimin e planit të integritetit. Raporti i monitorimit tregon se 60% e masave të tij për atë periudhë zbatimi që është në monitorim janë zbatuar.	2	Eksperti vlerëson raportin e monitorimit dhe analizon masat e hartuara dhe ato të zbatuara për periudhën në monitorim. Nëse 60% e masave janë zbatuar institucioni vlerësohet me pikë të plota. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	Raporti i monitorimit përmban rekomandime (të paktën një rekomandim) për përditësimin e planit të integritetit.	2	Të analizohet raporti i monitorimit të planit të integritetit, dhe të evidentohen rekomandimet për përditësimin e tij. Eksperti vlerëson me pikë të plota nëse raporti i monitorimit përmban të paktën një rekomandim për përditësimin e planit të integritetit. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	Institucioni ka emëruar një person përgjegjës për zbatimin e planit të integritetit - personi përgjegjës ushtron funksionin në bazë të vendimit të emërimit ku specifikohen përgjegjësitë dhe detyrat	2	Eksperti verifikon dokumentacionin dhe vlerëson me pikë institucionin nëse struktura/ personi përgjegjës ekzistojnë dhe kanë të përshkruara qartë detyrat dhe përgjegjësitë. Eksperti vlerëson me pikë të plota nëse përcaktimet e mësipërme ekzistojnë. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
Kontrolli i zbatimit në praktikë		10	
Pikët për integritetin strategjik:		20	

Tabela 6: Indeksi i Integritetit - Standardet etike dhe të sjelljes së mirë

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
Standardet etike/të integritetit	Institucioni ka një Kod Etike/Sjellje apo një seksioni përkatës në një akt tjetër të brendshëm.	2	Arkivohet Kodi i Etikës i miratuar/ rregullorja e brendshme që ka një seksion të veçantë për etikën dhe integritetin në institucion. Nëse ndonjëri nga këto dy dokumente ekziston, eksperti vlerëson me pikë të plota institucionin. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	Institucioni ka zhvilluar seanca informative/ trajnime për kuadrin rregullator për etikën dhe integritetin me punonjësit e institucionit (administratë dhe staf politik)	1	Eksperti konfirmon se institucioni ka zhvilluar seanca informative/trajnimi, ka hartuar materiale promovuese dhe ndërgjegjësuese për etikën. Arkivohet dokumentacioni i vënë në dispozicion nga njësitë e burimeve njerëzore që dëshmon kryerjen e trajnimeve/fushatave ndërgjegjësuese. Eksperti vlerëson me pikë të plota edhe nëse institucioni dëshmon së paku një aktivitet/dokument të vetëm. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	Plani vjetor i trajnimeve të institucionit përmban trajnime për etikën dhe integritetin.	1	Ekspertit i vihen në dispozicion plani vjetor i trajnimeve dhe evidentohen trajnime me fokus etikën. Nëse plani i trajnimeve përmban qoftë dhe një aktivitet të tillë, institucioni vlerësohet me pikë të plota. Në të kundërt institucioni vlerësohet me 0 pikë.
Rregullat dhe procedurat për sjelljen jo-etike dhe mbrojtjen e sinjalizuesve	Institucioni ka krijuar një njësi përgjegjëse dhe funksionale që regjistron, heton dhe shqyrton në mënyrë administrative raportet për veprimet ose praktikatat e dyshuara korruptive;	1	Vlerësuesi duhet të arkivojë një kopje të skanuar të vendimit të institucionit për krijimin e njësisë. Nëse dokumentacioni i plotë ekziston, institucioni vlerësohet me pikë të plota. Në të kundërt institucioni do të vlerësohet me 0 pikë.
	Institucioni ka hartuar një rregullore të brendshme të miratuar që përcakton procedurat për hetimin administrativ të rasteve të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit	1	Eksperti konfirmon ekzistencën e një rregullore të brendshme për sinjalizimin dhe vlerëson me pikë të plota institucionin. Në të kundërt institucioni do të vlerësohet me 0 pikë. Eksperti arkivon dokumentacionin ekzistues.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
	Rregullat dhe procedurat për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e mangësive, mospërputhjeve dhe shkeljeve jo-etike.	1	Eksperti duhet të kontrollojë dhe të arkivojë si pjesë e vlerësimit ekzistencën e rregulloreve dhe procedurave që aplikohen për raportim dhe hetim të situatave problematike në institucion. Eksperti duhet të raportojë/dokumentojë të paktën një rast të trajtuar nga institucioni për të vlerësuar me pikë të plota. Nëse nuk ekziston asnjë praktikë institucioni vlerësohet me 0 pikë.
Rregullat për konfliktin e interesit	Institucioni ka ngritur autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit dhe ka miratuar rregulloren përkatëse.	2	Eksperti duhet të arkivojë një kopje të rregullores së brendshme të institucionit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike si edhe vendimin për ngritjen e autoritetit përgjegjës për konfliktin e interesit në institucion. Eksperti vlerëson me pikë të plota kur ekzistojnë të dy dyja aktet. Nëse mungon vetëm një nga dokumentet e mësipërme institucioni vlerësohet me 0 pikë. Eksperti arkivon dokumentacionin ekzistues
	Institucioni raporton rregullisht për ILDKPKI me regjistrin e konfliktit të interesit .	1	Eksperti në bashkëpunim me institucionin duhet të arkivojë dhe vlerësojë raportin e fundit që është dorëzuar në ILDKPKI. Eksperti vlerëson me pikë të plota, nëse ka një raport të tillë. Nëse nuk ekziston një raport në tre vitet e fundit, institucioni vlerësohet me 0 pikë.
Kontrolli ligjor dhe institucional		10	
Kontrolli i zbatimit në praktikë			
	Numri i rasteve të raportuara apo trajtuara për konflikt interesi në një vit. (Referojuni njërit nga tre vitet e fundit nga periudha që po aplikoni vlerësimin).	2	Eksperti t'u referohet dokumentacionit të burimeve njerëzore dhe raporteve të brendshme të institucionit. Institucioni merr vlerësim me pikë të plota nëse ka <5 raste të tilla në vit. Institucioni vlerësohet me 0 pikë nëse nuk ka raportime të tilla ose kur rastet e raportuara janë >5 raste në vit.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objektivi i vlerësimit / Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
	Numri i rasteve të raportuara si raste të marrjes së ryshfetit, veprime korruptive dhe abuzim me detyrat (në një vit, referojuni një nga tre vitet e fundit nga koha që po aplikoni vlerësimin)	2	Eksperti t'u referohet burimeve njerëzore dhe raporteve të brendshme të institucionit. Institucioni merr vlerësim me pikë të plota nëse ka <5 raste të tilla në vit. Institucioni vlerësohet me 0 pikë nëse nuk ka raportime të tilla ose kur rastet e raportuara janë >5 raste në vit.
	Numri i raste të regjistruara si dhurata apo mikpritje ((në një vit, referojuni njërit nga tre vitet e fundit nga viti që po aplikoni vlerësimin).	2	Eksperti i referohet burimeve njerëzore dhe raporteve të brendshme të institucionit. Institucioni merr vlerësim me pikë të plota nëse ka <5 raste të tilla në vit. Institucioni vlerësohet me 0 pikë nëse nuk ka raportime të tilla ose kur rastet e raportuara janë >5 raste në vit.
Niveli i ekzistencës dhe zbatimit të standardeve të integritetit	Akte të brendshme që dëshmojnë se ndërmerren veprime sipas Kodit të Etikës/të Sjelljes ose udhëzimeve për standardet e integritetit të institucionit.	2	Eksperti i referohet dokumentacionit të burimeve njerëzore, raporteve të brendshme për zbatimin e Kodit të Etikës, raporteve të brendshme të institucionit për të evidentuar raste të sjelljeve të pahijshme të trajtuara sipas Kodit të Etikës/Sjelljes në institucion. Institucioni merr vlerësim me pikë të plota nëse ka <5 raste të tilla në vit. Institucioni vlerësohet me 0 pikë nëse nuk ka raportime të tilla ose kur rastet e raportuara janë >5 raste në vit.
	Vlerësim të rasteve të sinjalizuara të hetuara administrativisht nga njësi përgjegjëse (sipas nenit 13/1 të ligjit nr. 60/2016).	2	Numri i rasteve të hetuara administrativisht nga institucioni në vlerësim. Institucioni vlerësohet me pikë të plota nëse nuk raporton raste të sinjalizuara të hetuara ose ka deri në 3 raste të tilla në vit. Nëse institucioni raporton mbi 5 raste të hetuara në bazë të sinjalizuesit do të vlerësohet me 0 pikë. Eksperti arkivon dokumentacionin e venë në dispozicion (numrin e rasteve si statistikë ose një praktikë të një rastit hetimor duke hequr të dhëna personale).
Kontrolli i zbatimit në praktikë		10	
Pikët për standardet e integritetit		20	

Tabela 7: Indeksi i Integritetit – Meritokracia

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objekti/Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
Kontrolli ligjor dhe institucional			
Rekrutimi sipas meritës	Vendet e lira të punës në institucion shpallen publikisht. Meritokracia reflektohet në shpalljen e kërkesave për t'u përmbushur nga kandidatët.	2	<p>Ekspertit ti jepen të dhënat e mëposhtme për një vit kalendarik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • numri i vendeve të punës të shpallura (në vit) • numri i të punësuarve në total (në vit) • numri i vendeve të shpallura por të paplotësuara. <p>Eksperti zbret nga numri i vendeve të shpallura, numrin e vendeve të shpallura por të paplotësuara e më pas bën raportin me numrin total të të punësuarve në institucion.</p> <p>Eksperti e merr këtë informacion në raportet vjetore të DAP ose nga raportimet/dokumentet e njësisë të Burimeve Njerëzore</p> <p>Eksperti vlerëson me pikë të plota institucionin, nëse ky raport është 1. Institucioni vlerësohet me 0 pikë nëse ky raport është i ndryshëm nga 1.</p>
	Ka mungesë të punësimit me transparencë, ekzistojnë raste të bëra publike në media.	2	Nëse ekziston një rast i punësimit jo meritokratik, të raportuar në media institucioni vlerësohet me 0 pikë. (Gjatë një viti, referojuni vitit përpara atij që po kryhet vlerësimi.) Në të kundërt, eksperti vlerëson me pikë të plota institucionin.
Vlerësimi i / analiza e performancës së stafit	Institucioni ka një praktikë të vlerësimit të performancës së punonjësve.	2	Eksperti konsulton me njësinë e Burimeve Njerëzore ekzistencën e praktikës së vlerësimit të performancës që përfshin: udhëzimin për punonjësit për procesin, formularët e vlerësimit. Institucioni vlerësohet me pikë të plota nëse eksperti konfirmon ekzistencën dhe arkivon një praktikë të vlerësimit. Në të kundërt institucioni do të vlerësohet me 0 pikë.
	Raporti vjetor i performancës së punonjësve është hartuar, nga i cili formulohen udhëzime për menaxhimin e burimeve njerëzore.	2	Institucioni vlerësohet me pikë të plota nëse raporti i performancës së stafit ekziston. (Raporti i vihet në dispozicion ekspertit dhe arkivohet nga ky i fundit). Nëse raporti nuk ekziston, eksperti vlerëson me 0 pikë institucionin.

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objekti/Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
Trajnimi dhe edukimi	Plani vjetor i trajnimeve i institucionit.	2	Institucioni vlerësohet me pikë të plota nëse ekziston një plan trajnimesh vjetor për punonjësit e institucioneve. (Plani vjetor i trajnimeve vihet në dispozicion ekspertit). Eksperti vlerëson me 0 pikë, nëse plani vjetor i trajnimeve nuk ekziston.
Kontrolli ligjor dhe institucional		10	
	Numri i punonjësve të larguar nga puna/ totalit të numrit të të punësuarve (në%).	2	Eksperti i referohet për vlerësim raportit të dhënë nga njësitë e burimeve njerëzore ose DAP. Institucioni vlerësohet me pikë të plota nëse ky tregues i raportit është <15%. Institucioni vlerësohet me 0 pikë nëse ky tregues është >15%.
	Drejtoret e drejtorive kryejnë funksionet e tyre ligjore ne procedurat e emërimit/shkarkimit te stafit	2	Intervista me përfaqësues të njësisë së Burimeve Njerëzore në institucion. Vlerësimi të kryhet duke shqyrtuar raportin e vënë në dispozicion nga njësia burimeve njerëzore/ Raportin e DAP. Institucioni vlerësohet me pikë të plota nëse ka evidenca që drejtuesit e një drejtorie kanë kompetenca për emërimin/ shkarkimin e punonjësve të tyre në varësi. Në të kundërt, institucioni vlerësohet me 0 pikë.
	A sigurojnë rregulloret e brendshme/Kodi Etik aktivitetin politik të punonjësve ekzistues të sektorit publik (p.sh. anëtarësimi në parti, shprehja e pikëpamjeve politike)?	2	<p>Eksperti shqyrton kuadrin rregullator të institucionit për të kuptuar si rregullohet aktiviteti politik i punonjësve.</p> <p>Krahas shqyrtimit të kuadrit rregullator eksperti merr të dhëna mbi rastet e trajtuara dhe krahason: numrin e vërejtjeve që janë dhënë për stafin për aktivitet të papërshtatshëm politik/numrit total të vërejtjeve të dhëna (në një vit).</p> <p>Nëse ky raport është i ndryshëm nga zero (pra kur ka të paktën një rast te ndjekur), institucioni merr pikët e plota. Sa më i lartë ky raport aq më intensive janë përpjekjet e institucionit për të parandaluar aktivitetin politik jo-etik (të ndaluar nga rregulloret).</p> <p>Nëse institucioni nuk raporton raste, ky raport del zero dhe vlerësimi për institucionin do jete 0 pikë. Asnjë rast evident tregon se në institucion nuk ka përpjekje për të kufizuar aktivitetin politik jo-etik.</p>

Kontrolli ligjor dhe institucional	Objekti/Mënyra e Verifikimit	Vlerësimi	Rekomandime Metodologjike
	A kanë drejtuesit hapësira për tu dhënë punonjësve stimuj që të kryejnë punën me transparencë, përgjegjshmëri dhe gjithë përfshirje, p.sh. nëpërmjet çmimeve, stimujve financiarë etj.?	2	Evidenca të mekanizmave promovuese të aplikuara dhe numri i punonjësve që kanë përfituar në një vit (Raport/informacion i dhënë nga burimet njerëzore i cili arkivohet nga eksperti). Institucioni vlerësohet më pikë të plota nëse ky mekanizëm ekziston dhe ka evidencë qoftë dhe një rast te vetëm. Eksperti duhet të shqyrtojë rastin/procedurat për të vendosur vlerësimin. Nëse s'ka të tillë mekanizëm, vlerësimi është me 0 pikë.
	Raste të ankesave/konflikteve në punë të adresuara në KSHC ³	2	Eksperti të marrë statistika/tregues nga burimet njerëzore dhe raporti i KSHC. Nëse institucioni ka 0 deri ne 3 raste të raportuara në KSHC vlerësohet me pikë të plota. Nëse ka më shumë se 3 raste, institucioni vlerësohet me 0 pikë. Eksperti arkivon dokumentacionin e një rasti te inspektuar duke ruajtur anonimatin dhe respektuar të drejtën e të dhënave personale.
Niveli i zbatimit të standardeve të meritokracisë		10	
Total		20	

3 Rastet të mosmarrëveshjeve në punë të ndjekura nga KSHC tregojnë për mos-funksionim të praktikave të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion. Shumë raste (më shumë se 3) tregojnë për një ambient konfliktual dhe mungesë etike dhe integriteti.

REFERENCA

- Graycer. A & Sibbentom. A (2012). Corruption and control: A corruption reduction approach. Journal of financial Crime 19 (4). (disponueshme https://www.researchgate.net/publication/263695877_Corruption_and_Control_A_Corruption_Reduction_Approach)
- Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2018) "Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore : UNDP
- Monkova. M. (2015) "Udhëzues për planifikimin e integritetit dhe menaxhimin e integritetit, Kosovë: UNDP.
- Selinsek, Liljana (2015) "Corruption Risk Assessment in Public Institutions in South East Europe Comparative Study and Methodology", Regional Corporation Council, f. 18 (e disponueshme: http://rai-see.org/wpcontent/uploads/2015/10/CRA_in_public_ins_in_SEE-WEB_final.pdf)